

Fiscal, Customs Amnesty and Automobile Deregistration/Amnistia Fiksale, Doganore dhe Heqja nga Qarkullimi i Mjeteve të Transportit

13 April 2017

On 30 March 2017, the Albanian Parliament approved Law no. 33/2017 which implements the full/partial amnesty of most national and local tax liabilities, customs liabilities, as well as tax obligations relating to automobiles and their deregistration.

Tax Liabilities

The following tax liabilities will be unconditionally waived:

- National and local taxes which have not been paid relating to tax periods up to December 2010, irrespective of the date when they were detected;
- Penalties and interests related to social and health contributions for tax periods up to December 2010, excluding the tax liabilities;
- All obligations related to entities deregistered from the National Business Centre through a court order or deregistered from the tax administration up until the date when the law comes into force;
- Penalties for late tax declaration filing as well as employee declaration, as long as the respective declarations are submitted within 30 June 2017;
- Penalties for the late filing of financial statements and any profit distribution decision evidenced until December 2016.

Penalties and interests for the late-payment or non-payment of obligations recorded before this law comes into force will be waived on condition that, within 31 December 2017, the taxpayers will pay the full amount of:

- Tax liabilities relating to the tax periods January 2011 - December 2014;
- Social and health contributions relating to the tax periods January 2011 - December 2014;
- Local taxes and tariffs that have not been paid relating to tax periods January 2011- December 2014.

13 prill 2017

Më 30 mars 2017, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 33/2017 i cili përcakton një amnisti të plotë/pjesëshme të shumë taksave kombëtare dhe lokale, detyrimeve doganore, si dhe detyrimeve në lidhje me mjetet e transportit dhe çregjistrimi i tyre.

Detyrimet tatimore

Në bazë të ligjit, do të fshihen detyrimet e mëposhtme:

- Fshihen detyrimet tatimore të papaguara kombëtare dhe vendore që i përkasin periudhave tatimore dhjetor 2010 e më parë, pavarësisht datës kur janë evidentuar;
- Gjjobat dhe kamatëvonesat për sigurimet shoqërore e shëndetësore që i përkasin periudhave tatimore dhjetor 2010 e më parë, pa detyrimin tatimor që lidhet me to;
- Të gjitha detyrimet tatimore që u përkasin subjekteve që rezultojnë të çregjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me vendim gjykatë apo që janë çregjistruar në administratën tatimore deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji;
- Gjjobat për mosdeklarim në afat për deklaratat e pa dorëzuara tatimore si dhe punonjësit e padeklaruar, me kusht që këto deklaratat të dorëzohen brenda datës 30 qershor 2017;
- Gjjobat për dorëzim të vonuar të pasqyrave financiare dhe të vendimit për destinimin e rezultatit të evidentuara deri më dhjetor 2016.

Gjjobat dhe kamatëvonesat për pagesën e vonuar ose mospagesën e detyrimeve që rezultojnë para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të fshihen me kushtin që, brenda datës 31 dhjetor 2017 të paguhet të plotë:

- Detyrimet tatimore që u përkasin periudhave janar 2011 - dhjetor 2014;
- Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që u përkasin periudhave janar 2011 - dhjetor 2014;
- Taksat dhe tarifatat vendore të pa paguara që u përkasin periudhave janar 2011- dhjetor 2014.

Customs Liabilities

With regards to Customs, all payable obligations incurred for tax periods up to December 2010 will be unconditionally waived.

In addition, all obligations related to:

- Tobacco products for individuals;
- Deferred and unpaid VAT on machinery and equipment whose import is currently VAT exempt,

for tax periods up to 31 December 2016 and previously evidenced by the Customs Administration within 31 December 2016, will be unconditionally waived.

Whereas, any other obligations except the above, arising during the periods January 2011 - December 2014 will be waived, on condition that, the taxpayer pays the full customs liabilities, excluding penalties, interests and compensating interests, within 31 December 2017.

Moreover, any penalties/fines identified by the Customs administration during the periods January 2011 to December 2016, for vehicles which violated the temporary admission regime, will be waived on condition that taxpayers pay the full customs liability within 31 December 2017.

Tax and Customs Liabilities with ongoing appeal proceedings

Taxpayers currently appealing these tax and customs obligations will benefit from the amnesty as long as they renounce the claim, the legal case or the administrative recourse and subject themselves to the provisions of this law.

Automobiles and other transport vehicles

With regard to transport vehicles, the law foresees the deregistration of all automobiles and other transport vehicles registered with the General Road Transport Service Directorate (GRTSD) for which no action has been performed after 31 December 2011.

All unpaid obligations, including the yearly automobile registration tax, the used automobile tax, the luxury car tax, as well as any related penalties for failure to settle these obligations, relating to these vehicles will be waived.

Detyrimet doganore

Do të fshihen të gjitha detyrimet doganore të evidentuara nga kjo administratë për periudhat deri në dhjetor 2010.

Gjithashtu, të gjitha detyrimet që lidhen me:

- Produktet e duhanit për individët;
- TVSH e shtyrë ose të papaguar për makineritë dhe pajisjet, importi i të cilave është i përjashtuar nga TVSH.

që i përkasin periudhave tatimore deri në 31 dhjetor 2016 e më parë dhe të cilat janë evidentuar nga administrata doganore deri në 31 dhjetor 2016, do të fshihen pa kushte.

Për sa i përket detyrimeve të tjera të lindura përveç sa më sipër, gjatë periudhave janar 2011 - dhjetor 2014, ato do të fshihen me kushtin që brenda datës 31 dhjetor 2017, tatimpaguesi të paguajë plotësisht të gjitha detyrimet doganore, pa përfshirë gjobot, kamatëvonesat dhe interesat kompensuese.

Për më tepër, detyrimet e pagueshme në doganë të evidentuara për shkelje të regjimit të lejimit të përkohshëm për automjetet nga janar 2011 deri në dhjetor 2016, fshihen me kusht që brenda datës 31 dhjetor 2017, të paguhet i plotë detyrimi i pagueshëm në doganë, pa përfshirë gjobot dhe kamatëvonesat.

Detyrimet tatimore dhe doganore në proces ankimi

Subjektet që janë në proces apelimi të këtyre detyrimeve, përfitojnë nëse heqin dorë nga ankimi administrativ, padia apo rekursi dhe i nënshtrohen dispozitave të këtij ligji.

Automjetet dhe mjetet e tjera të transportit

Lidhur me mjetet e transportit, ligji parashikon çregjistrimin e të gjitha mjeteve të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, për të cilat nuk është kryer asnjë veprim pas datës 31 dhjetor e në vijim.

Të gjitha detyrimet e papaguara, përfshirë taksën vjetore të regjistrimit të automjeteve, taksa vjetore e mjeteve të përdorura, taksa e mjeteve luksoze si dhe gjobot e llogaritura për efekt të mospagimit të këtyre detyrimeve do të fshihen.

The GRTSD will perform deregistration procedures, at no cost, after 31 December 2017, unless the taxpayer or individual requests that the vehicle remains active. In such cases, only the obligations that belong to the tax periods up to 2010 will be waived, on condition that all tax obligations concerning the tax periods from January 2011 onwards are paid in full. This excludes the penalties and interests for the periods January 2011 to December 2014, which will be unconditionally waived.

[Source: Draft Law no. 33/2017, issued by the Council of Ministers, published on 30 March 2017 at www.parlament.al.]

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor do të kryejë pa pagesë procesin e çregjistrimit pas 31 dhjetor 2017, me përjashtim të rasteve kur taksapaguesi bën kërkesë për mbajtjen në qarkullim të mjetit. Në këto raste, do të fshihen vetëm detyrimet që i përkasin periudhave deri në 2010, me kushtin që të paguhen të plota të gjitha detyrimet që i përkasin periudhës nga janari 2011 e në vijim, me përjashtim të gjobave dhe kamatëvonesave të periudhës janar 2011 deri në dhjetor 2014, të cilat do të fshihen.

[Burimi: Draft Ligji nr. 33/2017, lëshuar nga Këshilli i Ministrave, botuar tek më 30 mars 2017 tek parlament.al.]

Let's talk

For a deeper discussion of how these issues might affect your business, please contact:

PricewaterhouseCoopers Audit Sh.p.k
Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1

Telephone: +355 4 22 90 700
Email: pwc.albania@al.pwc.com
Web: www.pwc.com/al

Loreta Peçi
Country Managing Partner
Tax and Legal Services

loreta.peci@al.pwc.com

Lorena Gega
Manager
Tax Services

lorena.gega@al.pwc.com

Erold Kamberi
Assistant Manager
Tax Services

erold.kamberi@al.pwc.com

The material contained in this publication is provided for general information purposes only and does not contain a comprehensive analysis of each item described. Before taking (or not taking) any action readers should seek professional advice specific to their situation. No liability is accepted for acts or omissions taken in reliance upon the contents of this publication.

© 2017 PricewaterhouseCoopers Audit Sh.p.k. All rights reserved. PwC refers to the PwC network and/or one or more of its member firms, each of which is a separate legal entity. Please see pwc.com/structure for further details.